



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 24.1.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË DOGANËS SË
KOSOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, Qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Doganës së Kosovës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Blerim Kabashi (udhëheqës i ekipit), Ariana Rexhëbeqaj dhe Leonora Hasani (anëtare të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Samir Zymeri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	22
5 Qeverisja e mirë.....	22
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	25
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	28
Shtojca III: Letër konfirmimi	33

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Doganës së Kosovës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, për vitin 2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Doganës së Kosovës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Doganës, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Doganës së Kosovës (DK). Ne kemi analizuar veprimtarinë e Doganës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e Menaxhmentit ndaj gjetjeve tona mund të gjenden në Shtojcën III.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

1. Opinion i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e DK për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, nr.01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Drejtori i Përgjithshëm i DK-ës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Doganës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga DK kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit më kohë.

Deklarata e bërë nga Menaxhmenti i DK-ës

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF, është e saktë dhe e drejtë. Gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PFV-të.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit është menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare në përgjithësi kontrollet janë të mira, mirëpo përmirësim të mëtejshëm kërkojnë fusha e personelit, prokurimit dhe menaxhimi i pasurive. Po ashtu si rrjedhojë moszbatimit me konsistencë të rregulloreve, fusha e të hyrave vazhdon të përcjellët me dobësi dhe mangësi në menaxhimin e tyre.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	8,977,368	8,808,863	8,490,434	7,838,762	7,597,000
Granti i Qeverisë -Buxheti	8,977,368	8,808,863	8,490,434	7,838,762	7,597,000

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 168,505€. Ky zvogëlim është pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2017, DK ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 8,490,434€, për 3% nivel më i ulët se vitin 2016, që ishte 99%.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	8,977,368	8,808,863	8,490,434	7,838,762	7,597,000
Pagat dhe Mëditjet	5,838,713	5,654,921	5,654,921	5,587,296	5,247,000
Mallrat dhe Shërbimet	1,745,280	2,185,648	1,924,564	1,565,043	1,913,000
Shërbimet komunale	193,375	164,375	107,510	96,595	92,000
Investimet Kapitale	1,200,000	803,919	803,439	589,828	345,000

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti fillestar për paga dhe mëditje ishte 5,838,713€, me rishikimit të buxhetit është shkurtuar për 32,713€, ndërsa në fund të vitit më vendim të Ministrit të Financave është zvogëluar edhe për 151,079€ si rrjedhoje e mos rekrutimit të stafit të planifikuar;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime është rritur për 440,368€. Me vendim të Qeverisë janë ndarë 342,000€ për nevojat e DK (Banderola, Qiraja dhe shërbime kontraktuese) dhe 52,115€ për shpenzimet e anëtarësimit ne Organizatën Botërore të Doganave, si dhe shuma prej 46,253€ për mbulimin e shpenzimeve analizave kimike, shpenzime të internetit;
- Në kategorinë e Investimeve Kapitale buxheti fillestar ishte 1,200,000€. Me rishikim të buxhetit ishte zvogëluar për 396,081€. Pasi me vendime të MF janë larguar/anuluar katër projekte, si: Implementimi i VoIP, renovimi i objekteve doganore, sistemi i konfirmimeve me bar-kod dhe sistemi softuerik i Doganave të Kosovës sipas standardeve si dhe projekti furnizime me pajise të IT-së.

Tabela 3. Te hyrat e inkasuar për buxhetin e Kosovës - realizmi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	Realizimi 2017	Realizimi 2016	Realizimi 2015
Të hyrat bruto	1,108,450,000	1,108,450,000	1,121,097,000	1,051,419,000	951,808,000
Kthimet	(9,300,000)	(9,300,000)	(9,144,000)	(7,377,000)	(6,879,000)
Të Hyrat neto	1,099,150,000	1,099,150,000	1,111,953,000	1,044,042,000	944,929,000

DK në vitin 2017, kishte realizuar të hyra prej 1,121,097,000€ apo 12,647,000€ më shumë se sa planifikimi si dhe për 69,678,000€ apo 7% më shumë se në vitin 2016. Të hyrat nga TVSH në kufi janë rritur 8% si dhe të hyrat nga akciza në kufi janë rritur për 7% në raport me vitin 2016. Ndërsa, sa i përket të hyrave nga dogana kemi një zvogëlim për 3,977,230€ si rrjedhoje e zbatimit të politikave të MSA ku në produkte të caktuara është eliminuar dhe përshkallëzuar taksa doganore.

DK në raportin e monitorimit të realizimit të planit vjetorë kishte shpjeguar se rritja e të hyrave në vitin 2017 ishte edhe si rezultat i ndërmarjes së veprimeve nga menaxhmenti i DK-së, në forcimin

e kontrolleve duke rezultuar me veprime shitesë në uljen e in-formalitetit si dhe veprimet anti kontrabandë.

Çështja 1 - Keq klasifikimi i buxhetit

E gjetura Sipas nenit 3 të Rregullës Financiare 02/2013 - për menaxhimin e pasurive jo financiare - Pasuri kapitale nënkupton të gjitha pasuritë jo financiare që kanë afat të përdorimit më të gjatë se një vit, vlerë financiare mbi 1,000€, pronësia dhe kontrolli janë të organizatës.

Pagesa për “Furnizim me pajisje dhe licenca për Sistemet Doganore” në vlerë prej 66,581€ është kryer nga kategoria investime kapitale përkatësisht nga kodi ekonomik 31680, duke u trajtuar nga DK si pasuri e paprekshme. Mirëpo, pajisjet dhe licencat kanë afat përdorimi njëvjeçar duhet të buxhetohen dhe të paguhen nga kategoria mallra dhe shërbime.

Rreziku Klasifikimi/raportimi jo i drejtë i shpenzimeve ndikon në mbivlerësimin e investimeve kapitale dhe nënvlerësimin e mallrave dhe shërbimeve dhe shpie në një keqkuptim të informatave financiare në PFV-të e DK-së.

Rekomandimi 1 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ka kontrolle të mira që sigurojnë planifikim/klasifikim adekuat të projekteve bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari-MF.

3.2 Të hyrat

DK në përgjithësi ka një sistem funksional në menaxhimin e të hyrave. Të hyrat doganore të planifikuara nga Qeveria e Kosovës për vitin 2017 janë 1,108,450,000€. Të hyrat neto për vitin 2017 janë 1,111,953,015€ duke përfshirë kthimet në vlerë -9,144,094€.

Tabela 4. Të hyrat e inkasuara dhe kthimet sipas kodeve ekonomike (në €)

Përshkrimi	Shuma 2017	Shuma 2016	Shuma 2015
Akciza në kufi	419,968,063	390,905,186	349,876,450
Akciza e brendshme	12,311,278	12,374,036	10,756,400
Dogana në import	125,992,685	129,931,679	131,390,851
TVSH në kufi-dogana	557,775,781	514,339,311	456,518,488
Masat anti damping	330,197	0,00	0,00
Tatimet e taksa. tjera	516,693	548,759	153,228
Kontrolle e jashtëm doganore	2,266,388	1,832,084	1,353,172
Kundërvajtje doganore	1,095,533	906,347	938,760
Banderolat	359,736	382,567	508,057
Të hyrat nga shitja e mallrave	269,983	198,689	313,039
Të hyrat nga gjykata	210,772	0,00	0,00
Fast-dogana	0,00	707	0,00
Kthimi i akcizës	-7,590,977	-5,758,537	-4,783,372
Kthimi i taksës doganore	-281,883	-489,407	-370,704
Kthimi i TVSH-së	-1,027,722	-1,094,227	-1,223,579
Kthimi taksa tjera doganore	-243,512	-34,756	-500,923
Të hyrat neto	1,111,953,015	1,044,042,438	944,929,867

Ne kemi analizuar menaxhimin e procesit të të hyrave me rastin e importimit të mallrave dhe përcaktimit të vlerës doganore. Vlera doganore, i referohet vlerës së mallrave të importuara, përdoret për të llogaritur detyrimet doganore të importit dhe tatimet. Shumica e importeve vlerësohen në bazë të "vlerës së transaksionit" (çmimi i kontratës), apo çmimi i paguar ose që duhet paguar për mallrat në vendin e tyre të eksportimit kur shiten në Kosovë, me disa përshatje të caktuara. Megjithatë, në qoftë se nuk është e mundur për të përdorur vlerën e transaksionit, janë pesë metoda tjera të vlerësimit të cilat mund të përdoren sipas radhës. Ne testuam të hyrat nga Tatimi në vlerën e shtuar (TVSh), Akciza dhe Dogana. Përmes rasteve/mostrave të testuara kemi identifikuar dobësitë në vijim:

Çështja 2 - Mangësi në kalkulimin e bazës doganore dhe mos aplikimi i çmimeve uniforme, me rastin e rivlerësimit të mallrave për qëllime tatimore

E gjetura Për importin/DUD me numër 2020-1409, artikulli nr. 1 i cili përbehet prej pesë pozicioneve në sasi prej 107,300 copë/syza, me rastin e rivlerësimit të bazës doganore, për dy pozicione Dogana ka pranuar çmimin fatural ndërsa tri pozicione janë rivlerësuar. Me këtë rast, baza doganore është rritur nga 51,610€ në 61,159€. Në bazën doganore pas rivlerësimit nuk janë përfshirë shpenzimet e transportit për dy pozicione që është pranuar çmimi transaksionit. Me këtë rast baza doganore do të duhej të jetë në vlerë prej 62,815€. Si rrjedhojë ngarkesa tatimore për biznesin është më e ulët, dhe ka shmangieje në të hyra për 493€.

E gjetura Në një rast kemi identifikuar se artikulli i njëjtë, i importuar më kushte të njëjta është vlerësuar me vlera/çmime të ndryshme, për qëllime të kalkulimit të detyrimeve doganore.

Rasti - importi i artikullit (maica nga pambuku për të rritur), nga i njëjti biznes, vendi origjinës i njëjtë, vendi eksportues i njëjtë, përshkrimi dhe kushtet e dërgesës të njëjta mirëpo në periudha kohore të ndryshme.

a. Importi/DUD-i me numër 2020-22100, kodi tarifor 61091000 më datë 12.05.2017, vlera e transaksionit/faturës 4,283€ për 23,796/copë me rastin e përcaktimit të vlerës për kalkulim të detyrimeve doganore nga zyrtarët doganorë nuk është pranuar vlera e faturës. Me rastin e rivlerësimit vlera është rritur në 9,523€, çmimi mestar i bie 0.40cent/copë.

b. Importi/DUD me numër 2020-26807, kodi tarifor 61091000, më datë 02.06.2017, vlera e transaksionit/faturës 5,313€ për 26,568/copë me rastin e përcaktimit të vlerës për kalkulim të detyrimeve doganore, nuk është pranuar vlera e faturës. Me rivlerësim vlera është rritur në 7,968€. Çmimi mesatar i bie 0.29cent/copë.

Për arsye të diferencës në vlerësim/çmim të artikullit biznesi në importin e dytë me vlerë transaksioni prej 5,313€, është ngarkuar më pak më detyrime doganore për 792€.

Lidhur më këtë rast Dogana ka marrë veprime përmes kontrolles pas importuese dhe kanë korrigjuar vlerësimin e mëparshëm të bazës doganore.

Rreziku Mangësitë në kalkulimin e bazës doganore dhe mos aplikimi i çmimeve uniforme me rastin e rivlerësimit të bazës doganore për pasojë mund të ketë trajtim jo korrekt dhe jo të barabartë të bizneseve si dhe shmangieje në të hyra. Më tutje mund të ndikojë edhe në prishjen e ekuilibrave në rrjedhën e tregtisë.

Rekomandimi 2 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se funksionojnë kontrollet dhe janë ndërmarrë veprime për të mundësuar një proces korrekt të vlerësimit të deklaratave doganore, unifikim të vlerës doganore si dhe trajtim të barabartë të bizneseve.

Çështja 3 - Zhvillimi i proceduarave import, në mungesë të licencës

E gjetura Sipas nenit 4 të UA nr.02/2012 për lëshimin e licencës për pagesën e taksës së akcizës dhe shumën e taksës administrative, çdo subjekt për të ushtruar veprimtarinë duhet të parashtrroje kërkesën për marrjen e licencës për pagesën e taksës së akcizës në DK.

Në importin/DUD më numër 2017242, datë 05.01.2017 janë importuar cigare në vlerë prej 251,087€, në mungesë të licencës valide. Biznesit i kishte skaduar afati i licencës në fund të vitit 2016.

Rreziku Zhvillimi i procedurave import/eksport në mungesë të licencës valide paraqet dobësi në procedurat/kontrollet doganore dhe rrit rrezikun e shmangies së tyre.

Rekomandimi 3 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë funksionim të plotë të kontrolleve dhe procese/procedura korrekte në pikat doganore. Procedurat eksport/import të zhvillohen nga bizneset e pajisura me dokumente/licenca valide duke ofruar siguri dhe konkurrencë të drejtë në treg.

Çështja 4 - Aplikimi i metodave të vlerësimit jo sipas kërkesave të kodit doganor

- E gjetura** Neni 34 i Kodit Doganor përcakton se kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2.
- Ne kemi vërejtur tri raste kur metodat nuk janë përdorur në mënyrë kronologjike, sipas kërkesave të Kodit Doganor.
- a. Zyra doganore në Prizren, importimi i mallrave me nr. tarifor 721420000 (hekur periodik, shufra çeliku); importuesi, origjina e mallit, kushtet e dërgesës dhe procedura doganore të njëjta. Më rastin e rivlerësimit të mallrave për 15 DUD/importe është përdorur metoda dy dhe në 14 DUD/importe është përdorur metoda gjashtë e vlerësimit;
- b. Zyra doganore në Prizren, më rastin e importimit të mallrave më nr. tarifor 7213914900 (armatura në rrathë); importuesi, origjina e mallit, kushtet e dërgesës dhe procedura doganore të njëjta, më rastin e vlerësimit të mallrave për 12 DUD/importe është përdorur metoda tre e vlerësimit dhe për 20 DUD/importe është përdorur metoda gjashtë e vlerësimit; dhe
- c. Zyra doganore në Ferizaj, më rastin e importimit të mallrave me nr. tarifor 7213914900 (armaturë në rrathë); importuesi, origjina e mallit, kushtet e dërgesës dhe procedura doganore të njëjta, më rastin e vlerësimit të mallrave për katër DUD/importe është përdorur metoda tre e vlerësimit, në shtatë DUD/importe është përdorur metoda gjashtë e vlerësimit.
- Rreziku** Aplikimi i metodave të ndryshme të vlerësimit për mallrat identike apo të ngjashme, me kushtet të njëjta, rrit rrezikun në përcaktimin jo të drejtë të vlerës së mallrave me rastin e rivlerësimit.
- Rekomandimi 4** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se sistemi i kontrollit sa i përket përcaktimit të vlerës së mallrave për detyrime doganore dhe tatimore bëhet në mënyrë uniforme që përjashton mundësin për përdorimin e vlerave doganore jo të arsyeshme/parimore.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe MF. Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e Pagave në DK për vitin 2017 është 5,654,921€, i cili ishte shpenzuar në masën prej 100%.

Çështja 5 - Pozita drejtuese më ushtrues detyre dhe mos harmonizimi i koeficienteve për stafin-shërbyes civil

E gjetura Udhëzimi administrativ nr. 37/2016 për rregullimin e marrëdhënies e punës së oficerëve doganorë ndër të tjera ceket se DP do të plotësoj një pozitë përkohësisht duke u bazuar në propozimet e udhëheqësit të departamentit dhe drejtorit të drejtorisë përkatëse, por jo më gjatë se gjashtë muaj”.

Në 20 raste (tre në shërbimin civil dhe 17 doganor) pozitat menaxhuese/kyçe si udhëheqës sektori, udhëheqës departamenti, drejtor të departamenteve, dhe pozita të zyrtarëve të ndryshëm janë mbuluar me ushtrues detyre. Për tri rastet në shërbimin civil pas procesit të gradimit, emërimet e rregullta janë bërë në fillim të vitit 2018. Gjendja më UD ishte edhe vitin e kaluar. Sipas menaxhmentit të Doganës kjo situatë ka rrjedhur si rezultat i pritjes së ndryshimeve që do të bëhen me konsolidimin e dy Agjencioneve (DK dhe ATK).

E gjetura Koeficientet për disa pozita në DK nuk janë në harmoni/nivel të njëjtë me Ministrinë e Financave si tërësi, përfshirë Agjencionet e saj. Pozitat zyrtar certifikues, zyrtar i prokurimit, zyrtar financiar si dhe zyrtar i pasurisë në DK, i kanë koeficientët më të ulët se sa janë për pozitat e njëjta në MF.

Rreziku Mbulimi i pozitave kyçe menaxheriale me UD për kohë më të gjatë se kërkesat ligjore si dhe mos harmonizimi i koeficientëve/pagave, rrit rrezikun e mos arritjes së objektivave dhe përgjegjësia apo performanca e kërkuar në këto pozita të mos jetë në nivelin e duhur.

Rekomandimi 5 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet që për pozitat e mbuluara me UD të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme me pozita të rregullta, dhe çështja e koeficienteve për stafin e DK të jetë e unifikuar në harmoni me kërkesat ligjore.

3.4 Menaxhimi i personelit

Ne testuam menaxhimin e proceseve në aspektin e pajtueshmërisë sa i përket menaxhimit të aktiviteteve në fushën e personelit, dhe identifikuam këto raste:

Çështja 6 - Mos funksionalizmi i plotë i strukturës së re organizative

E gjetura Bazuar në numrin e aprovuar të stafit për Doganën e Kosovës (DK) prej 642 konform Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017, DK-ja kishte hartuar planin e shpërndarjes së stafit konform UA nr.39/2017 për Strukturën Organizative të Doganës së Kosovës.

Sipas strukturës organizative aktuale DK kishte 509 oficer doganor (OD) dhe 74 shërbyes civil (ShC), ndërsa sipas planit të shpërndarjes së stafit për plotësim të Strukturës Organizative 2017 ishin paraparë 558 oficer doganor dhe 84 shërbyes civil. Mirëpo deri më tani kjo strukturë nuk është plotësuar, janë ende edhe 59 pozita të pa plotësuara.

DK gjatë vitit 2017 ka ndërmarrë disa veprime për plotësimin e strukturës organizative, Drejtori i Përgjithshëm këtë çështje e ka ngritur edhe tek MF. Mirëpo, pasi Ministria e Financave ka në plan të bëjë ndryshime të legjislacionit doganor (Kodit Doganor dhe të Akcizave), si rrjedhojë, është sugjeruar që struktura organizative të jetë në përshtatje me legjislacionin e ri dhe planifikimeve të politikave të reja të Ministrisë.

Rreziku Mos plotësimi apo vonesat në mbulimin e pozitave të caktuara me kandidatë përkatës, mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e aktiviteteve operacionale dhe arrijtjen e objektivave të përcaktuara të Doganës.

Rekomandimi 6 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të veprime të vazhdueshme ligjore, që për pozitave të paplotësuara të bëhet një zgjidhje e qëndrueshme në pajtim me kërkesat ligjore.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 2,185,648€. Prej tyre janë shpenzuar 1,924,564€, apo 88% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me furnizim me veshmbathje, karburante për vetura, shërbimet kontraktuese tjera, si dhe shpenzimet e udhëtimit zyrtare.

Buxheti final për komunalitet në vitin 2017 ishte 164,375€. Prej tyre janë shpenzuar 107,510€, të buxhetit. Këtu hyjnë shpenzimet e rrymës dhe telefonave.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2017 ishte 803,919€. Prej tyre janë shpenzuar 803,439€ pothuaj 100%. Me këto mjete janë realizuar pesë projekte që kanë të bëjnë me furnizimin me pajisje të IT-se dhe Softuerë për sistemet e Doganës.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale. Ne testuam nga pesë procedura të prokurimit në të dy kategoritë ku identifikuam parregullsitë si ne vijim:

Çështja 7 - Nënshkrimi i kontratës para zotimit të mjeteve

E gjetura	Për kontratën "Furnizim me uniformë për personelin e Doganës së Kosovës" pjesa II në vlerë 298,676€, e nënshkruar më datën 22.03.2017, zotimi ishte bërë me datën 06.04.2017. Pa zotim të mjeteve, janë nënshkruar edhe kontratat kornizë për "Shërbime të analizave kimike dhe testim të parametrave të derivateve të naftës - Pjesa I çmimi për njësi 358€ ndërsa realizimi në vitin 2017 prej 19,628€ dhe pjesa II çmimi për njësi 425€, realizimi 21,034€. Ndërsa planifikimi për secilën pjesë ishte nga 120,000€/pjesë për tri vite.
Rreziku	Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme mund të rezultojë në vonesa të implementimit të kontratës si dhe mos kryerjen e obligimeve me kohë.
Rekomandimi 7	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që ka kontrolle të mira në procesin e menaxhimit të aktiviteteve të prokurimit dhe se funksionimi i tyre të monitorohet në vazhdimësi gjatë tërë procesit.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Udhëzuesi kryesor në këtë fushë është rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore. Vlera e pasurive jo financiare kapitale me vlerë mbi 1,000€ e paraqitur në PFV ishte 4,340,505€, vlera e pasurisë jo financiare nën 1,000€ ishte 381,218€ dhe stoqet 171,000€.

Çështja 8 – Mos përdorimi i sistemit e-pasuria

E gjetura Përkundër rekomandimeve të dhëna në raportet e viteve paraprake, për të regjistruar pasurit nën 1,000€ në sistemin e-pasuria, edhe me tutje gjendja ishte e njëjte. Pasuritë jo kapitale dhe stoqet nuk janë menaxhuar përmes softuerit e-pasuria, mirëpo ato janë evidentuar dhe raportuar përmes një sistemi të brendshëm të tyre. Zyrtarët e Doganës kanë deklaruar se nga muaji Prill të vitit 2018 kanë filluar futjen në funksion dhe menaxhimin e pasurive jo financiare nën 1,000€ përmes sistemit e-pasuria.

Rreziku Mos menaxhimi i pasurive jo kapitale nën 1000€ përmes sistemit e-pasuria si dhe regjistrimi i pasurive në data baza të ndryshme vështirësojnë menaxhimin efektiv të tyre dhe se kjo mund të bartë rreziqe në prezantimin dhe raportimin e saktë të tyre.

Rekomandimi 8 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që veprimet e ndërmarra janë të mjaftueshme dhe të monitoroj nga afër funksionalizimin e sistemit e-pasuria, në mënyrë që të sigurohet se pasurit jo kapitale regjistrohen dhe menaxhohen përmes këtij sistemi.

3.9 Llogaritë e arkëtueshme

DK ka të vendosur një sistem të kontrollit të brendshëm që mbikëqyrë procesin e llogarive të arkëtueshme duke e menaxhuar këtë proces përmes sektorit për menaxhimin e borxheve. Megjithatë Llogaritë e arkëtueshme vazhdojnë të jenë e të larta, vlera e tyre në fund të vitit 2017 ishte 41,883,666€. Kjo vlerë është më e ulët për 1,611,745€ në raport me vitin 2016.

Çështja 9 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

- E gjetura** Trajtimi dhe mbledhja e të arkëtueshmeve vazhdon të mbetet sfidë për DK. Përkundër veprimeve të ndërmarra për mbledhjen e borxheve dhe përcjellja e lëndëve në procedurë përmbartimore dhe gjykatë, vlera e të arkëtueshmeve është ende e lartë. Në anën tjetër subjektet ekonomike vazhdojnë të mos kryejnë pagesën e borxheve ndaj DK-së.
- Rreziku** Mungesa e efikasitetit për inkasim të të arkëtueshmeve mund të ndikoj negativisht në subjektet tjera që ti paguajnë obligimet e tyre me kohë, ndërsa vjetërsia e tyre e vështirëson inkasimin.
- Rekomandimi 9** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë kontrolle adekuate rreth menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, si dhe në koordinim me organet përkatëse të ndërmerren veprime në rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre.

3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara në fund të vitit 2017 ishte 15,003€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Ne testuam raportet mujore të obligimeve si dhe pesë fatura të obligimeve të prezantuara në PFV. Testet tona në këtë kategori shpalosen se menaxhimi dhe raportimi i obligimeve është bërë në pajtueshmëri me legjislacionin. Ndërsa mangësi vërehen tek detyrimet kontingjente.

Çështja 10 - Detyrimet kontingjente

- E gjetura** Nga të dhënat e Avokaturës Shtetërore janë 156 raste që janë ngritur padi ndaj Doganës. Ndërsa në PFV Dogana kishte prezantuar detyrim kontingjent në vlerë 11,770,000€. Ne po ashtu kemi vërejtur mungesë të koordinimit të duhur ndërmjet Doganës me Avokaturën Shtetërore rreth lëndëve/informatave mbi detyrimet kontingjente për prezantimin e tyre në PFV.
- Rreziku** Mungesa e një qasje adekuate për trajtimin e detyrimeve kontingjente rrit mundësinë e shndërrimit të tyre në obligime që do të shkaktonte keqësimin e pozitës financiare të organizatës.
- Rekomandimi 10** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj kontrolle adekuate në këtë fushë, të siguroj raportim cilësorë dhe bashkëpunim/koordinim me Avokaturën Shtetërore me qëllim të përfaqësimit adekuat të institucionit në gjykata.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016, ka rezultuar me 12 rekomandime. DK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, shtatë rekomandim janë zbatuar, dy ishin në proces dhe tri nuk janë zbatuar ende. Rekomandimet e pa zbatuara janë mbulimi i pozitave më ushtrues detyre, keq klasifikimi i projekteve dhe mos funksionimi i sistemit e-pasuria. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe dy rekomandime të cilat nuk janë adresuar, mbulimi i pozitave më ushtrues detyre dhe keq klasifikimi i projekteve kapitale.

Çështja 11 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

- E gjetura** Përkundër hartimit të planeve për zbatimin e rekomandimeve të AP, edhe me tutje ka rekomandime të pa zbatuara nga dy vitet e mëhershme. Si rrjedhojë organizata përballet ende me dobësi të njëjta.
- Rreziku** Zbatimi jo i plotë i rekomandimeve ndikon në mos përmirësimin e dobësive të identifikuar, dhe si rezultat në vazhdimësi kemi përsëritjen e mangësive të njëjta.
- Rekomandimi 11** Drejtori i Përgjithshëm duhet të zbatojë një proces efektiv për monitorimin e implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm (AP), i cili përcakton kohën e synuar dhe zyrtarët përgjegjës për këtë. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Ne vlerësojmë progresin e bërë të DK-së sa i përket raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe përgatitjes së raportit për menaxhimin e rrezikut. Po ashtu niveli i zbatimit të rekomandimeve të vitit paraprak, është një tregues i përpjekjeve për zhvillimin e mëtutjeshëm të proceseve nga ana e menaxhmentit të DK-së. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e DK po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit.

Menaxhimi i rrezikut është një prej parimeve kryesore të qeverisjes së mirë, në këtë aspekt Drejtori i Përgjithshëm (DP) ka përgatitur/hartuar regjistrin e rreziqeve si dhe është themeluar komiteti

për menaxhimin e rreziqeve për përmirësimin e kualitetit të kontrolleve doganore dhe realizimin sa më të mirë të objektivave institucionale.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

DK në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Qeverisja në Doganën e Kosovës në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. Dogana ka hartuar me kohë planin për zbatimin e rekomandimeve, mirëpo progresi nuk është i mjaftueshme. DK ka përmbushë kërkesën lidhur me dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit. Lista e vet-vlerësimit e plotësuar nga MF kishte paraqitur gjendje të saktë të organizatës dhe ishte përcjell me dëshmitë përkatëse. DK kishte hartuar strategjinë gjithëpërfshirëse të zhvillimit të institucionit për vitet 2017-2019, planin për menaxhimin e rreziqeve si dhe planin për monitorimin e rreziqeve. Megjithatë DK është në fazë të pa përfunduar (tranzitore) sa i përket organizimit të brendshëm të saj, menaxhimit të personelit në përgjithësi.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

NJAB në skemën organizative është njëri nga segmentet kyçe të kontrolleve të brendshme.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me tre anëtarë - Drejtori i NJAB-së dhe dy auditor. NJAB kishte hartuar planin strategjik dhe vjetor ku janë planifikuar tetë auditime gjatë vitit 2017. Kjo njësi ka përmbushur në tërësi planifikimin duke dhënë rekomandime konkrete për përmirësimin dhe funksionimin e kontrolleve të brendshëm.

Drejtoritë/departamentet që auditohen nga NJAB obligohen të raportojnë në periudha tremujore lidhur me nivelin e implementimit të rekomandimeve.

NJAB raporton për punën e saj edhe në NJQHAB përmes raporteve tremujore dhe linja tjetër e raportimit është Komiteti i Auditimit i cili është themeluar në kuadër të Ministrisë së Financave.

Komiteti i Auditimit, për periudhën janar-dhjetor 2017 ka mbajtur katër takime ku janë shqyrtuar raportet e AB, të gjeturat dhe implementimi i rekomandimeve të tyre. Megjithatë, menaxhmenti nuk ka marrë masa të duhura për të adresuar rekomandimet.

Çështja 12 - Niveli i ulët i adresimit të rekomandimeve të NJAB-it

- E gjetura** Raportet e auditimit të brendshëm nuk ishin trajtuar në nivelin e duhur nga menaxhmenti, pasi që një numër i vogël i rekomandimeve të tyre ishin zbatuar. Nga gjithsej 38 rekomandimet e dhëna në tetë raportet e auditimit vetëm 16 prej tyre ishin zbatuar ndërsa 22 rekomandime ishin në proces të adresimit. Komiteti i auditimit (KA) nuk kishte dhënë ndonjë kontribut domethënës në këtë proces.
- Rreziku** Mos adresimi i rekomandimeve të AB-së dhe trajtimi jo i duhur i raporteve të tyre nga KA dhe Menaxhmenti, do të ketë ndikim negativ në funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme si dhe rritë rrezikun që gabimet dhe mangësitë e njëjta të përsëriten në vazhdimësi.
- Rekomandimi 12** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë një bashkëpunim të ngushtë dhe komunikim efektiv në mes menaxhmentit, KA dhe NjAB-së për të identifikuar mangësitë e kontrolleve të brendshme dhe për të ndërmarrë veprime që rekomandimet e AB-së të gjejnë zbatim në praktikë. Më tej, KA duhet të forcojë rolin e vet në këtë proces, duke e mbajtur menaxhmentin më përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

DK është agjenci në kuadër të MF-it, PFV-të e saj konsolidohen në kuadër të PFV-ve të MF-së. Për të siguruar një menaxhim financiar efektiv nevojitet një proces efektiv i konsolidimit dhe raportimit me kohë. DK-ja ka strukturën e saj organizative, menaxhuese dhe llogaridhënëse dhe se Drejtori i Përgjithshëm raporton te Ministri i Financave në periudha të rregullta mujore. Departamentet në kuadër të DK-së kanë plane veprimi për zbatimin e objektivave të parapara me aktivitetet e tyre operative, dhe njëherit në baza mujore dhe tremujore kryejnë monitorimin apo matjen e arritjes së objektivave të përcaktuara me plan strategjik.

Ndonëse Menaxhmenti ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, DK edhe më tutje duhet t'i kushtojë rëndësi më të madhe proceseve në menaxhimin e të hyrave, fushën e personelit, prokurimit, llogarive të arkëtueshme, detyrimeve kontigjente dhe pasurive.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që ka aplikuar një proces formal të monitorimit të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga AP, me qëllim që të mbaj llogaridhënës stafin përgjegjës për adresimin e rekomandimeve sipas afateve kohore të përcaktuara në planin e veprimit.		Ne proces, edhe pse menaxhmenti i Doganës ka përgatitur planin për implementimin e rekomandimeve, dhe në fund të vitit 2017 ka përgatitur një plan aksional për shkallen e implementimit rekomandimeve edhe me tutje duhet të ndërmerren veprime që ti beje përgjegjës zyrtaret e caktuar në kuadër të sektorëve të Doganës që shkalla e implementimit të rekomandimeve të jete në nivelin e pranueshëm.	
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se planifikimi dhe klasifikimi i projekteve të caktuara bëhet duke pasur për bazë planin kontabël të aprovuar nga Ministria e Financave.			Nuk është zbatuar

3.6.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet).	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se janë ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për mbulimin e pozitive të caktuara me punëtorë të rregullt. Më tutje, duhet të siguroj bazën e qartë ligjore lidhur me pagesën e rrezikshmërisë për personelin përbrenda institucionit si dhe marrjen e vendimeve me kohë për të evituar pushimet pa pagesë pa aprovime paraprake. Po ashtu, duhet të siguroj përditësimin e dosjeve të personelit në pajtueshmëri me detyrat dhe përgjegjësitë të cilat i ushtrojnë.			Nuk është zbatuar
3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se ka ndërmarr masa të duhura për funksionalizimin e sistemit me qëllim të evidentimit të të gjitha borxheve në sistemin NUXEO. Më tutje, duhet të vazhdoj të ndërmarr veprimet ligjore si dhe të bëjë një analizë në mënyrë që të nxjerr shkaktarët e dështimit të bizneseve në pagesën e borxheve.		Edhe përkundër veprimeve të ndërmarra nga sektori për menaxhimin borxheve, edhe me tutje kërkohen veprime shtese që vlera e borxheve të jete në nivel të pranueshme.	
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që shpalosjet paraqesin gjendjen e saktë dhe të plotë të të arkëtueshmeve (borxheve). Drejtori i Përgjithshëm po ashtu duhet të sigurojë që përgatitja e PFV-ve për vitin 2017 të përfshijë rishikimin e hollësishëm të draft pasqyrave nga menaxhmenti. Pas sigurimit të kontrolleve në rishikimin e PVF-ve, mund të nënshkruhet dhe dorëzohet deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.	Është zbatuar		

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet, duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor, si dhe stafin llogaridhënës për zbatimin e tyre. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi		Ne proces edhe pse menaxhmenti i Doganës ka përgatitur planin për implementimin rekomandimeve, dhe në funde të viti 2017 ka përgatitur një plan aksional për shkallën e implementimit rekomandimeve edhe me tutje duhet të ndërmerren veprime që të bëjë përgjegjës zyrtarët e caktuar në kuadër të sektorëve të doganës që shkalla e implementimit të rekomandimeve të jetë në nivelin e pranueshëm.	
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se departamentet përgjegjëse kanë ndërmarrë veprimet e kërkuara ligjore për hartimin e një UA i cili i përcakton dispozita të veçanta për trajtimin e të arkëtueshmeve (borxheve) doganore.	Është zbatuar		
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë forcuar linjat raportuese, në mënyrë që planifikimi dhe klasifikimi i projekteve të caktuara të bëhet duke pasur për bazë planin kontabël të aprovuar nga MF-ja.			Nuk është zbatuar
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ka instaluar kontrole shtesë në fazën e buxhetimit dhe të monitorimit të realizimit të projekteve, për të mundësuar më pas, regjistrimin dhe raportimin e shpenzimeve në pajtueshmëri me kërkesat për raportim.	Është zbatuar		

3.1.1 Të hyrat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcojë kontrollet për të siguruar se janë duke u respektuar të gjitha procedurat e përcaktuara ligjore. Në këtë aspekt, të sigurojë që subjekteve të cilat nuk paguajnë obligimet, ose nuk hyjnë në marrëveshje për ri-programim të borxhit t'i ndalohet eksport-import i mallrave dhe shërbimeve.	Është zbatuar		
3.1.1 Të hyrat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë kontrolle shtesë, si dhe të rrisë nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies në zhvillimin e procedurave doganore (përcaktimin e vlerës së importeve). Në këtë mënyrë do të eliminohet mundësia për gabime në vlerësimet doganore, si dhe do të reduktohet dukshëm numri i ankesave	Është zbatuar		
3.1.1 Të hyrat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë kontrolle shtese në mënyrë që të respektohen të gjitha kërkesat ligjore. Kërkesat e subjekteve për kthimin e taksës së akcizës duhet të dërgohen në Thesar për pagesë brenda afatit të përcaktuar ligjor.	Është zbatuar		
3.1.2 Pagat dhe mëditjet.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të përcaktojë me UA, një afat të arsyeshëm kohor për mbulimin e pozitave me UD, dhe të sigurojë se procedurat e rekrutimit fillojnë më kohë, dhe kohëzgjatja e funksionit si ushtrues detyre të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar. Gjithashtu të sigurojë se bëhet ndarje e duhur e detyrave dhe përgjegjësive për të arritur objektivat e DK-së.			Nuk është zbatuar

3.1.4 Investimet kapitale.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet në menaxhimin e kontratave, si dhe të sigurojë se të gjitha pagesat bëhen konform afateve të parapara me kontratë	Është zbatuar		
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale.	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që janë ndërmarr të gjitha masat e nevojshme që pasurit jo kapitale regjistrohen dhe menaxhohen përmes sistemit e-pasuria.			Nuk është zbatuar
3.2.2 Llogaritë e arkëtueshme (borxhet).	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e të arkëtueshmeve, rritjen e efikasitetit si dhe forcimin e kontrolleve në menaxhimin dhe arkëtimin e tyre. Në këtë aspekt, të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve në mënyrë që të ndërmerren veprimet ligjore për inkasimin e tyre.		Sektori i për menaxhimin e borxheve kishte arritur që të regjistrojë dhe raportojë borxhet përmes sistemi Lessi, dhe te harmonizoj vlerën e borxheve te raportuare me sektorin e financave, mirëpo edhe me tutje niveli i te arketueshmeve nuk është ne nje shkalle të pranueshme.	

Shtojca III: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
 Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs
 Zyra e drejtorit të përgjithshëm

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit
 Të nderuar,
 Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Doganës së Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Bahri Berisha
 Drejtor i Përgjithshëm - Dogana e Kosovës,
 Data: 28. Maj 2018, Prishtinë

